



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Prishtinë, më 2 shtator 2026

Z. Hajrulla Çeku, Ministër në detyrë
Ministria e Arsimit dhe Shkencës

Z. Përparim Rama, kryetar
Komuna e Prishtinës

LETËR REKOMANDIMI

R. nr. 1150/2025

Lidhur me mosveprimin institucional për ndarje të buxhetit për institucionin arsimor dhe mungesë të trajtimit efektiv të kërkesave të paraqitura nga Këshilli Drejtues i Shkollës

Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 26 gusht 2025 pranoi ankesën e z. Arben Nitaj (në tekstin e mëtejshme: ankuesi), anëtar i Këshillit Drejtues të ShFMU-së (KDSH) “Xhavit Ahmeti”, të parashtruar kundër Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH), lidhur me mosdhënien e përgjigjes ndaj kërkesës për ndërhyrje urgjente lidhur me moszbatimin e dispozitave ligjore nga Komuna e Prishtinës për ndarjen e buxhetit për vitin fiskal 2025.

Sipas ankuesit, mungesa e buxhetit po pamundëson kryerjen e riparimeve dhe investimeve të domosdoshme për funksionimin e rregullt të institucionit arsimor, përfshirë riparimin e dorezave të dyerve, mënjanimin e rrjedhjeve të ujit, zëvendësimin e dyerve të klasave, të cilat nuk janë ndërruar që nga viti 2009, si dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera elementare të mirëmbajtjes së përditshme. Ankuesi theksoi se ndarja e këtij buxheti është e një rëndësie të veçantë për garantimin e kushteve të sigurta, të përshtatshme dhe dinjitoze për zhvillimin e procesit mësimor. Sipas tij, mosalokimi i mjeteve financiare ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e mjedisit shkollor, cenon mirëqenien dhe sigurinë e nxënësve dhe të stafit, si dhe rrezikon funksionimin efektiv të shkollës.

Më 17 korrik 2025, në cilësinë e anëtarit të KDSH-së së ShFMU-së “Xhavit Ahmeti” në Prishtinë, ankuesi fillimisht i adresoi kërkesë Komunës së Prishtinës për ndarjen e buxhetit të rregullt vjetor për vitin fiskal 2025, por nuk mori asnjë përgjigje zyrtare.

Duke u bazuar në mosndërmarrjen e veprimeve nga Komuna e Prishtinës, më 18 gusht 2025, KDSH-ja parashtroi kërkesë në MASH për ndërhyrje urgjente për ndarjen e buxhetit, pasi neni 29 i Ligjit për Arsimin Parauniversitar (LAP) përcakton se në rast kontesti ndërmjet Komunës dhe KDSH-së, për sa i përket buxhetit, MASH-i ka për obligim të vendosë.

Në mungesë të përgjigjes nga MASH-i, KDSH-ja iu drejtua Zyrës së Kryeministrit më 9 shtator 2025 me kërkesë për ndërhyrje. Më 11 shtator 2025, z. Nitaj u njoftua nga Zyra e Kryeministrit se nga MASH-i ka kërkuar ndërmarrja e veprimeve të nevojshme, në përputhje me kompetencat e institucionit dhe legjislacionin në fuqi.

Më 22 tetor 2025, nëpërmjet e-mailit, ankuesi iu drejtua MASH-it me kërkesë përsëritëse për ndërmarrjen e veprimeve, por nuk mori përgjigje, e as nuk u ndërmor ndonjë veprim procedural.

Avokati i Popullit, pas shqyrtimit të ankesës, ndërmori veprimet në vijim:

Avokati i Popullit, më 30 tetor 2025, iu drejtua ministrit të MASH-it me kërkesë për informata lidhur me veprimet që planifikoheshin të ndërmerreshin.

Avokati i Popullit, më 18 nëntor 2025, pranoi përgjigje nga MASH-i, me të cilën u informua se, sipas legjislacionit dhe praktikës ekzistuese, planifikimi zhvillimor i shkollës bëhet në bashkëpunim ndërmjet komunës dhe shkollës, ndërsa miratohet nga Drejtoria Komunale e Arsimit (DKA). Gjithashtu, u informua se KDSH-ja nuk menaxhon drejtpërdrejt buxhetin apo financat e shkollës, por mbikëqyr realizimin e planit zhvillimor dhe shpenzimet nga donacionet që mund t'i ketë shkolla. MASH-i, ndër të tjera, theksoi se, për qartësimin e procesit, duhet të ekzistojë një qëndrim unanim i Këshillit Drejtues të Shkollës (KDSH), drejtorisë së shkollës dhe Drejtorisë Komunale të Arsimit, me arsyetimin se shkresat janë dorëzuar nga një anëtar individual i KDSH-së dhe jo nga e gjithë struktura kolegjiale.

Gjatë periudhes janar, mars e prill 2026 institucioni morri informata shtesë nga parashtruesi.

Dispozitat përkatëse ligjore lidhur me çështjen

Kushtetuta e Republikës së Kosovës¹, në nenin 47 [E Drejta për Arsimin] përcakton: “1. Secili person gëzon të drejtën e shkollimit themelor pa pagesë. Shkollimi i detyrueshëm rregullohen me ligj dhe financohet nga fondet publike. 2. Institucionet publike sigurojnë për secilin person mundësi të barabarta për t’u arsimuar, sipas aftësive dhe nevojave të veçanta të tij/saj.”

Ndërsa Kushtetuta në nenin 50 (Të Drejtat e Fëmijës) përcakton: “Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarrja qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve.”

Ligji nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, neni 5, obligon: “1. Të gjitha veprimet dhe vendimet, që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra nga prindërit apo kujdestari, institucionet, shërbimet për mbrojtjen e fëmijës, profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, gjykatat, autoritetet administrative apo nga organet legjislative, interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese dhe më e larta.”²

Ligji nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / nr. 17 / 16 shtator 2011, Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: LAP)³, në nenin 3, paragrafi 3, përcakton: “Është obligim i përgjithshëm i Ministrisë, komunave, institucioneve arsimore dhe të gjitha organeve të tjera, të përfshira në ofrimin e arsimit parauniversitar, siç është rregulluar përmes këtij ligji dhe ligjeve të tjera në fuqi, që të

¹ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

² <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844>

³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2770>

planifikojnë dhe ofrojnë shërbime efikase, efektive, fleksibile, gjithëpërfshirëse dhe profesionale, të dizajnuara për t'u ofruar të gjithë fëmijëve të drejtat e barabarta për shkollim, në pajtim me aftësitë dhe nevojat e tyre specifike, si dhe për të avancuar zhvillimin e tyre arsimor e social.”

Neni 17, paragrafi 1, i LAP-it, përcakton: “Çdo institucion publik arsimor dhe aftësues duhet të ketë këshillin drejtues. Në rast se këshilli drejtues nuk mund të formohet ose nuk mund të mbledhet në periudhën prej tre (3) muajsh, funksionet e tij merren nga drejtori i institucionit, me kusht që komuna (Ministria në rastet e institucioneve të nivelit 4 të ISCED-it) vazhdon me përpjekjet e mëtutjeshme për ta themeluar këtë këshill dhe për të mbajtur takimet e tij çdo tre (3) muaj.”

Gjithashtu, neni 17, paragrafi 8, i LAP-it, përcakton: “Drejtori i institucionit arsimor ushtron funksionin e Sekretarit të Këshillit drejtues. Drejtori i raporton Këshillit drejtues për çdo vit lidhur me aktivitetet dhe financat e institucionit, dhe ka të drejtën që të sugjerojë zgjidhje dhe të marrë pjesë në debate, por jo edhe të drejtën e votës. Drejtori i shkollës është përgjegjës për ligjshmërinë e punës së Këshillit.” Më tutje, paragrafi shtjellon: “11.3. të ushtrojë funksionet e ndërlidhura me shfrytëzimin e buxhetit të shkollës, përfshirë edhe skemën e delegimit mes komunës, organit drejtues të shkollës dhe drejtorit të shkollës, siç është përcaktuar në këtë ligj, dhe 11.7. të shpreh pikëpamjet e veta për çështjet që kanë të bëjnë me shkollën apo çfarëdo aspekti të arsimit parauniversitar.”

Po ashtu, LAP-i, në nenin 29, përcakton: “1. Komuna delegon përgjegjësinë për buxhet dhe financa tek institucionet arsimore dhe aftësuese sipas formulës komunale të specifikuara në një akt nënligjor, formula duhet të lejojë ndryshime nëse ndryshon numri i nxënësve gjatë vitit fiskal; 3.1. çdo Këshill drejtues duhet të ketë çdo vit fiskal një buxhet të alokuar dhe në bazë të asaj ndarje, miraton planin buxhetor; 3.2. Këshilli drejtues i institucionit mund të delegojë përgjegjësinë për shpenzime në fusha të specifikuara dhe me limite të specifikuara financiare te drejtori i institucionit. Aranzhimet e tilla i nënshtrohen orarit të delegimit, të miratuar dhe mund të anulohen nga komuna përkatëse; 4. Çdo kontest mes Këshillit drejtues të institucionit dhe drejtorit, sa i përket buxhetit të institucionit, i nënshtrohet një arbitrimi obligues të bërë nga komuna.” Kurse në paragrafin 5 sqarohet më tutje: “Çdo kontest mes komunës dhe këshillit drejtues, sa i përket buxhetit të institucionit, i nënshtrohet një arbitrimi obligues të bërë nga Ministria.”

Ligji nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës nr. 20, më 21 qershor 2016, në Prishtinë (në tekstin e mëtejshëm: LPPA), ka për qëllim të sigurojë realizimin efektiv të autoritetit publik në shërbim të interesit publik, duke garantuar njëkohësisht mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave juridike të personave. Gjithashtu, ky ligj rregullon dhe përcakton procedurën administrative, para së gjithash, si një tërësi normash juridike, me të cilat rregullohet mënyra e veprimit të organeve administrative shtetërore, të cilat, duke zbatuar normat e së drejtës materiale, nxjerrin akte administrative, me të cilat vendosin për të drejtat, obligimet ose interesat e subjekteve përkatëse të së drejtës.

Neni 9 i LPPA-së shprehimisht përcakton: “Organi publik duhet të garantojë të drejtën e palës për t'u informuar mbi ecurinë e procedurës administrative, qasjen në dosjen dhe dokumentet e tij dhe të drejtën e njoftimit me mjete të përshtatshme, në pajtim me këtë Ligj.” Gjithashtu, neni 11 i LPPA-së parasheh: “Organi publik, që zhvillon procedurën

administrative, siguron që mosdija e palës të mos përkeqësojë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave juridike, që ajo ka sipas ligjit. Organi publik, në veçanti, informon palën për të drejtat dhe detyrimet e saj në procedurën administrative, si dhe për pasojat juridike të veprimeve a mosveprimeve të saj gjatë kësaj procedure.”

Sipas nenit 97 të LPPA-së, procedura administrative e nisur me kërkesë përfundon me njoftimin e aktit administrativ. Në kuptim të nenit 98 të po këtij ligji, procedura administrative duhet të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat të veçantë, atëherë afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzet e pesë (45) ditë nga fillimi i saj, përjashtuar rastet e shtyrjes së afatit, të përcaktuara në nenin 99 të LPPA-së. Në rast të shtyrjes së afatit fillestar, pala duhet të njoftohet për këtë shtyrje, si dhe për datën e re të përfundimit të procedurës. Rrjedhimisht, ky ligj, në mënyrë të qartë, parasheh obligimin e organit administrativ për të vepruar pas pranimit të kërkesave të palëve dhe për t'i njoftuar ato lidhur me vendimin e organit. Po ashtu, neni 135 i LPPA-së përcakton se *akti administrativ që zgjidh ankesën do të nxirret dhe do t'i njoftohet palës brenda tridhjetë (30) ditëve nga parashtrimi i ankesës.*

Deri me datën e publikimit të këtij raporti, MASH-i dhe Komuna e Prishtinës nuk ofruan dëshmi me të cilën vërtetohet se ankuesi mori përgjigjen në ankesë.

Parimi i interesit më të mirë të fëmijës, i garantuar me nenin 50 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 5 të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, obligon të gjitha institucionet publike që, në çdo veprim dhe vendimmarrje, të kenë si konsideratë parësore mirëqenien, zhvillimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës. Në këtë kuptim, vonesat në ndarjen dhe ekzekutimin e mjeteve buxhetore nga komuna për institucionet arsimore mund të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe qasjen në arsim, duke penguar sigurimin e kushteve të përshtatshme mësimore, furnizimin me materiale dhe realizimin e aktiviteteve edukative në interes të nxënësve. Për pasojë, çdo vonesë e pajustificuar në alokimin e mjeteve financiare duhet të vlerësohet në dritën e detyrimeve kushtetuese dhe ligjore për mbrojtjen e interesit më të mirë të fëmijës, pasi efektet e saj mund të cenojnë ushtrimin e së drejtës themelore për arsim dhe zhvillimin e plotë të fëmijëve.

Nga sa u theksua më lart, Avokati i Popullit konstaton se Komuna e Prishtinës nuk ofroi përgjigje efektive dhe brenda afateve të arsyeshme lidhur me kërkesën e paraqitur nga ankuesi. Gjithashtu, vlerëson se përgjegjësia primare për sigurimin e buxhetit dhe funksionimit financiar të shkollës bie mbi Komunën, përkatësisht Drejtorinë Komunale të Arsimit, si autoritet kompetent për organizimin dhe financimin e arsimit parauniversitar në nivel lokal.

Avokati i Popullit vlerëson se, në rastet kur ekzistojnë konteste administrative, mungesë bashkëpunimi institucional ose moszbatim i dispozitave ligjore nga niveli komunal, MASH-i ka kompetencë mbikëqyrëse dhe detyrim për të ndërhyrë përmes mekanizmave ligjorë dhe administrativë, përfshirë interpretimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit.

Tutje, Avokati i Popullit konsideron se fakti që ankesa është paraqitur nga një anëtar i Këshillit Drejtues të Shkollës nuk e liron institucionin publik nga obligimi për ta shqyrtuar çështjen dhe për të kthyer përgjigje administrative, veçanërisht kur pretendimet kanë të bëjnë me financimin dhe funksionimin e institucionit arsimor, si dhe me interesin më të mirë të fëmijëve.

Avokati i Popullit konstaton duke marrë parasysh faktet e mësipërme, MASH-i është dashur të përgjigjet në kërkesën e ankuesit lidhur me obligimin e përcaktuar në paragrafin 5 të nenit 29 LAP.

Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore”; dhe sipas nenit 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, të Ligjit për Avokatin e Popullit, duhet: “Të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritete i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla.”

Prandaj, Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Komunës së Prishtinës:


1. Të vendosë lidhur me ankesën e z. Arben Nitaj, të parashtruar më 17 korrik 2025, duke e trajtuar atë në pajtim me dispozitat ligjore.
2. Ta trajtojë pa vonesë çështjen e ndarjes së buxhetit për institucionin arsimor dhe të sigurojë zbatimin e dispozitave të Ligjit për Arsimin Parauniversitar.

Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës:

1. Të ndërmarrë veprime konkrete në kuptim të nenit 29 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar lidhur me pretendimet e ngritura për ndarjen buxhetore për institucionin arsimor.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit-u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, [...] duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.”), ju lutemi të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerreni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Naïm Qelaj

Avokat i Popullit